



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2918/prot.
5

Tiranë, më 18 04.2023

URDHËR

Nr. 296 datë 18.04.2023.

PËR

**NGRITJEN E SEKRETARIATIT TEKNIK NË MBËSHTETJE TË GRUPIT
NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR HARTIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024-2030,
PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT, SI DHE PASAPORTËN E TREGUESVE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar", si dhe bazuar në urdhrin 50, datë 05.04.2023 të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të Planit të Veprimit dhe të Pasaportës së Treguesve".

URDHËROJ:

1. Marrjen e masave organizative, në kuadër të zbatimit të qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), nëpërmjet ngritjes së Sekretariatit Teknik për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, Planit të Veprimit, si dhe Pasaportën e Treguesve.
2. Rolin e Sekretariatit Teknik për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, Planit të Veprimit dhe Pasaportës së Treguesve do të kryhet nga Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë.
3. Sekretariati Teknik ka funksionet dhe detyrat në përputhje me Urdhrin nr. 157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, specifikuar si më poshtë vijon:

- a. siguron gjithë mbështetjen teknike për zhvillimin e takimeve dhe proceseve të lidhura me funksionimin e Grupit Ndërinstitucional të Punës;
 - b. koordinon punën ndërmjet institucioneve të përfaqësuara në grupin e punës, partnerëve për zhvillim, partnerëve socialë, si dhe aktorëve të tjerë të interesuar;
 - c. siguron drejtimin metodologjik, teknik dhe standartizues të punës për anëtarët e grupit të punës, për përgatitjen e instrumenteve respektive të planifikimit strategjik;
 - d. siguron përgatitjen dhe shpërndarjen e paketës së materialeve dhe agjendës përkatëse për mbledhjen e grupit ndërinstitucional të punës, minimalisht 5 ditë përpara zhvillimit të takimit;
 - e. siguron koordinimin e procesit dhe/ose përgatitjen e dokumentave të lidhura me instrumentet respektive të planifikimit strategjik/politikave duke koordinuar institucionet pjesëmarrëse, të cilat diskutohen në mbledhjet e Grupit Ndërinstitucional të Punës;
 - f. organizon mbledhjet duke propozuar çështjet për diskutim, të përgatitura në bashkëpunim me anëtarë dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm;
 - g. përgatisin minutat e të gjithë takimeve, duke siguruar shpërndarjen pas miratimit nga kryesuesi i Sekretariatit Teknik.
4. Ngarkohet Sekretariati Teknik për mbështetjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, Planit të Veprimit, si dhe Pasaportën e Treguesve për zbatimin e këtij urdhri.
 5. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë për përmbajtjen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ULSI MANJA

